



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teknikat e laborator i të folurit

Ngarkesa: 4 kredite; 60 orë mësimore; 0 leksione / 60 seminare
Viti / Semestri : Viti I ,Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë me përzgjedhje
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t'u japë studentëve shtysa për t'u shprehur lirisht e spontanisht, duke zhvilluar kështu aftësitë e ndërveprimit dhe prodhimtarisë gojore. Stimujt mund të jenë figura, tekste, këngë, filmime, të mbështetura në një gamë të gjerë situatsh dhe tematikash. Për secilin argument do të paraqitet një leksik i dobishëm për diskutimet dhe përshkrimin e situatave të caktuara. Aktivitete për shfrytëzimin e stimujve janë pyetje, luajtje e roleve (role-play), diskutimi në grup dhe në çifte, sipas një shkalle vështirësie rritëse dhe të një prodhimtarie gradualisht më të pavarur si rrjedhojë e së cilës ata do të përftojnë një zhdervjellësi leksikore e prezantuese gjithnjë e më të mirë çka është thelbësore në lëmin e përkthimit dhe interpretimit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zgjerojë njohuritë leksikore të studentit në bazë të përvojave dhe tematikave të njohura ku ai është në gjendje të përshkruajë veten, mjedisin përreth, të thotë dhe të mbrojë një ide,
2. Të argumentojë një qëndrim të vetin për tema të njohura të aktualitetit, t'i organizojë këto diskutime brenda caqeve kohore të caktuara duke respektuar rregullat e komunikimit dmth. duke pritur radhën e vet, duke folur në mënyrë të thjeshtë e të qartë, duke dëgjuar diskutimet e të tjerëve;
3. Të pohojë, mohojë, argumentojë, justifikojë, kundërshtojë apo mbrojë një zgjedhje, një vendim, apo një qëndrim, të vetin apo të të tjerëve.